



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.44/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Rrustem Thaqi, anëtarë, në çështjen disiplinore ndaj N. F., gjyqtar në Gjykatën Themelore në P., kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës (më tej KGJK), për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur sipas ankesës së gjyqtarit N. F., paraqitur kundër vendimit KGJK.nr.394/2023, datë 31.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19.10.2023 merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa themeltë, ankesa e N. F., gjyqtar në Gjykatën Themelore në P., e paraqitur kundër vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.394/2023, datë 31.08.2023.

A r s y e t i m

Me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.394/2023, datë 31.08.2023, në pikën I të dispozitivit ishte vendosur që N. F., gjyqtar në Gjykatën Themelore në P., është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuar në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafët 2.7 të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe pikën 5.5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë. Në pikën II ishte vendosur që për shkeljen disiplinore si në piken I të këtij dispozitivi, gjyqtarit N. F., i shqiptohet sanksioni disiplinor **vërejtje publike me shkrim**.

Kundër këtij Vendimi, gjyqtari N. F., në afat ka paraqitur ankesë, për shkak të aplikimit të gabuar të ligjit, dhe gabimeve faktike që kanë ndikuar në procedurë dhe vendimmarrje lidhur me masën disiplinore, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoi ankesën, të ndryshoi vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të konstatoi se nuk është përgjegjës për shkeljen që i ngarkohet.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në përgjigje ndaj ankesë së gjyqtarit pretendon se ankesa është e pa bazuar dhe se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë andaj i propozon Gjykatës Supreme që ta refuzoi ankesën si të pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të vendimeve të atakuar në kuptim të nenit 15 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve Nr. 06/L-057 dhe rregullores (05/2019) për Procedurën disiplinore të Gjyqtarëve të datës 27 maj 2019 ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (tutje "Këshilli"), me datën 30.11.2022 ka pranuar kërkesë nga Autoriteti Kompetent për fillimin e hetimit disiplinor me pretendim se N. F., gjyqtar në Gjykatën Themelore në P., mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafët 2.7 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe nga neni 5 pika 5.2 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarët.

Bazuar në faktet e prezantuara në kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor Autoriteti Kompetent (tutje si "Autoriteti") ka konsideruar se në çështjen penale me numër PKR.nr.190/2016, gjyqtari N. F., nuk kishte ndërmarrë veprimet konform përgjegjësisive të tij gjyqësore që të sigurohet se lënda PKR.nr.190/2016 të trajtohet me efikasitet. Po ashtu, sipas vlerësimit të Autoriteti subjekti i hetimit nuk kishte ndërmarr veprimet e duhura që të shmang zvarritjen dhe si rrjedhojë e mosveprimit të tij konstatohet se ka pasur zvarritje të procedimit të lëndës PKR nr. 190/2016. I njëjti për këtë rast nuk kishte caktuar seancë gjyqësore për katër (4) vite e nëntë (9) muaj, ndërsa kishte caktuar një numër të madh të seancave gjyqësore për lëndët e pranuar me vonë në gjykatë. Sipas pretendimit të autoritetit ekziston dyshimi i bazuar se i njëjti me mos veprimin e tij ka kryer shkelje disiplinore sipas nenit 5, par.2 nën.par. 2.7 të Ligjit nr. 06/L-057 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenin 5 pika 5.2 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë që lidhet me përgjegjësinë e gjyqtarit për organizimin e punës, andaj ka kërkuar nga Këshilli që të iniciohet procedurë disiplinore.

Paneli hetimor i themeluar me vendim KGJK.nr.11/2023, të datës 18 janar 2023, i ka dorëzuar Këshilli raportin me shkrim lidhur me gjetjet, gjegjësisht faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit të bërë për shkeljen disiplinore të pretenduar të subjektit hetimor. Këshilli ka mbajtur seancë dëgjimore datë 12.06.2023, dhe më datë 24.02.2023 është dëgjuar subjekti i hetimit në këtë rast gjyqtari N. F., dhe dëshmitarët me njohuri për rastin.

Paneli, gjatë shqyrtimit të çështjes ka gjetur se, subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari N. F., ishte ngarkuar me lëndën kontestuese PKR.nr.190/16, me datën 10.07.2017 dhe se i njëjti kishte mbajtur seancat për shqyrtim gjyqësor me datat 13.09.2017; dt.06.11.2017 dhe në seancën e datës 05.02.2018 kishte konstatuar me procesverbal se, mungojnë të dëmtuarit - dëshmitarët të cilët ishin të ftuar në mënyrë të rregullt sipas flete dërgesave të datës 05.10.2017 dhe dt.18.09.2017 me ç' rast në kthim të flet dërgesave është konstatuar se, palët janë të panjohura përkatësisht adresa e pasaktë. Ndërkaq po në të njëjtën seancë të datës 05.02.2018, gjyqtari N. F., kishte njoftuar njërin nga të akuzuarit në këtë çështje penale, që ka të drejtë të kërkoj mbrojtës me shpenzime publike duke u bazuar në dispozitën e nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale, të cilën kërkesë i akuzuari nuk e kishte bërë dhe nga data 18.09.2017 deri më 16.11.2022, gjyqtari F., nuk kishte ndërmarr asnjë veprim tjetër lidhur me caktimin e seancës gjyqësore. Paneli ka gjet si jo kontestuese faktin së subjekti i hetimit, ka kryer lëndë të pranuar me vonë se lënda e vitit 2016 dhe se i njëjti në seancën dëgjimore të dt.24.02.2023 para panelit ka pohuar se kishte trajtuar respektivisht kryer lëndë të pranua më vonë se lënda e cila është subjekti i kësaj çështje disiplinore, me ç' rast ka deklaruar se ka kryer lëndë vetëm me armëmbajtje kështu duke ju referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Paneli kishte vlerësuar të gjitha lëndët në punë gjatë periudhës përkatëse, nga muaji shkurt 2018 deri në fund të vitit 2022 ku subjekti hetimor kishte trajtuar 418 lëndë. Po ashtu, gjyqtari N. F., ka theksuar se ka pasur mungesë të stafit mbështetës - administrativ dhe në vazhdimësi kishte kërkuar në mbledhjet e kolegjiemeve të kryetarëve paraprak dhe kryetares aktuale se duhet të respektohet Rregullorja për Organizimin e Brendshme të Gjykatës, gjithashtu ai shtoi se, me rastin e ngritjes së aktakuzave, lëndët menjëherë iu dorëzohen fizikisht gjyqtarëve të cilat qëndrojnë në zyrat e gjyqtarëve, ndërkaq sipas gjyqtarit përkatësisht subjektit të hetimit të njëjtat do duhej të qëndrojnë në Zyrën për Menaxhimin e lëndëve ashtu siç e parashohin dispozitat e rregullores së lartcekur dhe i njëjti ka deklaruar se në një situatë të tillë patjetër se nuk ka mundësi t'iu përmbahet afateve kohore.

Në seancën e mbajtur dëgjimore pranë Këshillit më datë 12.6.2023, gjyqtari N. F., ka deklaruar se nuk e kundërshton raportin e prezantuar nga kryesuesja e panelit por e kundërshton në tërësi inicimin e kësaj procedure disiplinore lidhur me rastin konkret me arsyet se, lidhur me kryerjen e lëndëve të pranua më vonë se lënda e cila është subjekti i kësaj çështje disiplinore, i njëjti deklaroj se ka kryer lëndë vetëm me armëmbajtje. Kështu duke ju referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, përkatësisht neni 242 i KPP nr. 04/L-123, paragrafi 4 dhe 5 sipas të cilëve kryetari trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda 30 ditësh pas ngritjes së aktakuzës dhe në rastet kur i pandehur është në mbajtje apo paraburgim, në mundësin e parë, por jo me vonë se 15 dite pas ngritjes së aktakuzës. Po ashtu, i njëjti theksoj se ka qenë i

ngarkuar edhe me lëndët të cilat ishin nën monitorimin e Eulex-it të cilët edhe paraqiteshin në zyrë për caktimin e shqyrtimeve gjyqësore, gjithashtu gjyqtari N. F., shtoj se përveç lëndëve të DKR ishte i ngarkuar edhe me lëndë nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës një pjesë e të cilave ishin bartur në Departamentin Special të kësaj gjykate.

Këshilli, duke shqyrtuar raportin e panelit hetimor, me qëllim të vendosjes së çështjes në mënyrë meritore, në seancën dëgjimore të datës 12.06.2023 pas dëgjimit të kryesueses së panelit hetimor dhe subjektit të hetimit, në mënyrë unanime vendosi që t'i dëgjoj edhe dy dëshmitarët e propozuar nga subjekti i hetimit, dëshmitarët K.SH dhe F.D të cilët në dëshminë e tyre të dhënë në seancën e datës 28.07.2023 kanë pohuar faktin se të njëjtit janë ballafaquar me mbingarkesë të lëndëve në DKR dhe se në pyetjet e parashtruara në këtë seancë dëgjimore të njëjtit kanë pranuar se janë të detyruar të caktojnë lëndët me prioritet sipas ligjit dhe strategjisë së Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Këshilli gjeti se gjyqtari F., është i përfshirë në shkeljen disiplinor të pretenduar nga Autoriteti Kompetent për shkak të mos procedimit më tutje të lëndës penale PKR.nr.190/2016. Lëndën në fjalë gjyqtari F., e kishte pranuar me 10.07.2017 seancën parë për këtë çështje penale e kishte caktuar me datat 13.09.2017, dt.06.11.2017, dt. 05.02.2018 dhe nga kjo datë deri me dt.16.11.2022 subjekti i hetimit nuk kishte ndërmarr asnjë veprim tjetër lidhur me lëndën, gjithashtu nga provat e lartcekura, Këshillit nuk i ka ikur fakti se subjekti i hetimit gjegjësisht gjyqtari N. F., ishte i mbingarkuar me lëndët ashtu siç është pohuar gjatë dëgjimit të tij dhe dëshmitarëve të tjerë në këtë çështje. Këshilli vlerëson se periudha kohore prej katër (4) vite e nëntë (9) muaj në çdo rast nuk e justifikon mosveprimin e subjekti të hetimit me ç 'rast me neglizhencën e treguar dhe zvarritjen e shkaktuar nga gjyqtari F., i njëjti ka bërë shkelje ligjore sipas nenit 5, paragrafi nën paragrafët 2.7 të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve, ku përcaktohet se në vazhdimësi nuk i kryen detyrat zyrtare me kohë, siç kërkohet me ligj " dhe në dispozitën 5.5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë është përcaktuar se: "gjyqtari ushtron funksionin e tij në mënyrë efikase të ligjshëm " .

Shkeljet e sipër theksuara janë provuar me provat e administruara, të cilat i janë prezantuar Këshillit nga raporti fakt mbledhës të Panelit Hetimor janë dëshmuar me prova dhe subjektit i është dhënë mundësia të deklarohet rreth tyre. Ky raport është vlerësuar si i besueshëm pasi paneli, në mënyrë objektive dhe sipas procedurës së përcaktuar lidhore, ka zhvilluar procesin e hetimit të çështjes dhe vlerësimit të fakteve. Këshilli ka vlerësuar pretendimet e subjektit të hetimit, por ka

gjetur se në kuptim të fakteve të konsumuara me provat e administruara, këto pretendime nuk kanë ndikuar që Këshilli të marrë një vendim tjetër.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së gjyqtarit N. F., gjene se janë zbatuar drejtë dispozitat e nenit 15 të Ligjit që rregullojnë çështjen e ankimit ndaj vendimeve të KGJK-së, pranë Gjykatës Supreme të Kosovës. Por bazuar në shkresat e lëndës dhe arsyetimin e Vendimit të KGJK-së, ankesa e subjektit hetimore, është ushtruar ndaj vendimit të KGJK-së nuk mbështetet në fakte. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka vepruar në përputhshmëri me dispozitat e Ligjit në fuqi për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ka dëshmuar se është bërë shkelje disiplinore nga parashtruesja e ankesës, i ka shqiptuar masën disiplinore në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe ka marrë parasysh edhe seriozitetin, pasojat, rrethanat në të cilat është kryer shkelja. Prandaj pretendimet e ankesës për aplikim të gabuar të së drejtës materiale janë të pa bazuara dhe si të tilla u refuzuan. janë të paqëndrueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që vendimi i atakuar është marrë me zbatimin e drejtë të së drejtës material kur është vërtetuar përgjegjësia disiplinore gjyqtarit për shkeljen disiplinore të përcaktuara me nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, të Ligjit Nr. 06/L-055, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve është kur është shqiptuar edhe sanksioni disiplinor në përputhje me nenin 7 paragrafi 1 pika 2 e të njëjtit Ligj.

Pretendimi se veprimet e gjyqtarit edhe nëse janë shkelje kanë ardhur si pasojë e mungesës së stafit mbështetës, shkeljeve të Kodit të Procedurës Penale në fuqi në atë periudhë, shkeljet në zbatim të rregullores së Organizimit të Brendshëm të Gjykatës, për sa i përket mirëmbajtjes së dosjeve, nuk janë të qëndrueshme për arsye se nga vështirimi i lëndëve të kryera del se një numër i madh i lëndëve të pranuar më vonë janë kryer dhe varësisht edhe nga natyra janë pranuar më vonë dhe kryer më herët se rasti konkret. Në rastin konkret nuk është kryer asnjë veprim procedural për periudhën kohore prej katër (4) vite e nëntë (9) muaj në çdo rast nuk e justifikon mosveprimin e subjekti të hetimit me ç 'rast me neglizhencën e treguar dhe zvarritjen e shkaktuar nga gjyqtari F., i njëjti ka bërë shkelje ligjore. Lidhur me këtë pjesë të pretendimeve në ankesë Gjykata Supreme e Kosovës vëren se kanë qenë edhe pretendime në shqyrtimin para Këshillit dhe arsyetimi i dhënë nga Këshilli është i qartë dhe i ligjshëm dhe edhe kjo gjykatë e mbështet arsyetimin e dhënë në këtë pjesë.

Pretendimet për moszbatim të Rregullores së Organizimit të Brendshëm të Gjykatës duhen adresuar në mënyrë të paraparë me procedurë përkatëse tek autoriteti që e ka nxjerrë rregulloren por

nuk e shfajësojnë trajtimin jo kronologjik të lëndëve në punën e gjyqtarit e as nuk e lirojnë nga përgjegjësia e trajtimit ligjor të çështjeve në punën e tij, sepse menaxhimi i lëndëve i bie në përgjegjësi gjyqtarit të cilit i ngarkohen lëndët. Gjykata Supreme konsideron se shkelja është e paraparë me nenin 5.2.7, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i cili parasheh se Gjyqtari kryen shkelje disiplinore nëse "në vazhdimësi nuk i kryen detyrat zyrtare me kohë, siç kërkohet me ligj;" dhe sanksioni disiplinor i shqiptuar është në përputhje me nenin 7 paragrafi 1 pika 1.2; të njëjtit ligj.

Prandaj sipas Gjykatës Supreme të Kosovës masa e dhënë është në përputhje me parimin e proporcionalitetit duke marrë parasysh: seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga gjyqtari , pasojat e shkeljes disiplinore; rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore; Ky sanksion disiplinor i shqiptuar është në përputhje me shkeljet e gjetura si në raportin e Panelit hetimor ashtu siç parashihen në nenin 7 paragrafi 1.2 i Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Sipas Gjykatës Supreme të Kosovës është zbatuar procedura e paraparë sipas ligjit në fuqi dhe masa e dhënë është në përputhje me parimin e proporcionalitetit duke marrë parasysh: seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga prokurorja, pasojat e shkeljes disiplinore; rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore.

Në vështrim të dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës është e detyruar të kufizohet në shkaqet e parapara në Ligj për të cilat mund të paraqitet ankesa (nenin 15, pika 4.1 deri pika 4.3 të Ligjit), dhe atë vetëm në rast të zbatimit të gabuar të ligjit; në rast të shkeljes procedurale të përcaktuar me ligj; apo në rast të një gabimi faktik të qartë apo të dukshëm i cili ndikon në të drejtat substanciale të palës në qoftë se ndikon seriozisht në paanësinë dhe integritetin e procedurës;) dhe në rastin konkret asnjëra nga këto shkaqe nuk janë përmbushur.

Nga sa u tha në ankesë e në pajtim me nenin 15.6 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

AA.nr.44/2023 më 19.10.2023

Kryetari i Kolegjit

Beshir Islami